VENDIM
Nr.34, datë 22.7. 2005

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË DARFO ALBANIA SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa dh; 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 "Rregullorja për procedurat e licencimit", neni 5 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2005, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Darfo Albania" sh.p.k. për marrje të licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike, vetëm për të plotësuar nevojat e furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar "Darfo Albania" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë "Darfo Albania" sh.p.k., vetëm për të plotësuar nevojat e furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar "Darfo Albania" sh.p.k, për periudhën deri më 31.12.2006.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema